



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERËT PUBLIKË

Nr. 271/5 prot.

Tiranë, më 20.7.2022

- Lënda:** Ankim i Komisionerit Publik kundër vendimit nr. 537, datë 2.6.2022, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, për subjektin e rivlerësimit z. Florian Bonjaku
- Baza ligjore:** Neni 179/b, pika 5 e Kushtetutës, neni C, pika 2, neni F, pika 2 e aneksit të Kushtetutës, neni 63 i ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”
- Për kompetencë:** Kolegjit të Posaçëm të Apelit, pranë Gjykatës Kushtetuese
- Për dijeni:** Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit (ONM)
- Depozituar pranë:** Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

Të nderuar zonja/zotërinj, gjyqtarë të Kolegjit të Posaçëm të Apelit, pranë Gjykatës Kushtetuese,

Në zbatim të nenit 55, pika 7 e ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, pranë Institucionit të Komisionerëve Publikë, në datën 5.7.2022, është njoftuar vendimi nr. 537, datë 2.6.2022, i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, për subjektin e rivlerësimit z. Florian Bonjaku, me detyrë prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Krujë.

Komisioneri Publik, në mbështetje të nenit C, pika 2, nenit F, pika 2, të aneksit të Kushtetutës dhe nenit 63, pika 1, të ligjit nr. 84/2016, ka të drejtë të ankimojë vendimin brenda afatit 15-ditor, nga njoftimi.

Brenda afatit ligjor, Komisioneri Publik ushtron ankim ndaj vendimit nr. 537, datë 2.6.2022, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

I. Procesi i rivlerësimit dhe përfundimet e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

1. Subjekti i rivlerësimit ushtron detyrën e prokurorit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Krujë dhe, në bazë të nenit 179/b/3 të Kushtetutës së Republikës, së Shqipërisë i është nënshtruar rivlerësimit *ex officio*.

2. Bazuar në nenin Ç, pika 1 e aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016, procesi i rivlerësimit kalimtar për subjektin e rivlerësimit ka përfshirë kontrollin dhe rivlerësimin e të tria kriterëve, atë të pasurisë, të figurës dhe të aftësive profesionale.

3. Për këtë qëllim, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim referuar si Komisioni) ka administruar raportet e vlerësimit për këtë subjekt nga institucionet ndihmëse, si Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim referuar si ILDKPKI), Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim referuar si DSIK) dhe Këshilli i Lartë i Prokurorisë (në vijim referuar si KLP), nga të cilat rezulton se:

3.1 ILDKPKI, bazuar në nenin 33, pika 5, të ligjit nr. 84/2016, me anë të “Aktit të përfundimit të kontrollit të plotë të deklaratës së pasurisë”, ka referuar:

- i. *deklarimi nuk është i saktë në përputhje me ligjin;*
- ii. *ka paqartësi dhe mospërputhje lidhur me vlerat dhe burimet financiare të përdorura për pasuritë;*
- iii. *ka mosdeklarime të pasurisë ndër vite;*
- iv. *nuk ka kryer deklarim të rremë;*
- v. *subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.*

3.2 DSIK, bazuar në nenin 39, pika 2, e ligjit nr. 84/2016, fillimisht me anë të raportit mbi kontrollin e figurës për subjektin e rivlerësimit¹, ka referuar: “Përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës të subjektit të rivlerësimit”. Në vijim të informacioneve të ardhura, në kohështirje gjatë periudhës së rivlerësimit, DSIK ka dërguar një raport të dytë të përditësuar,² ku referon se subjekti mund të jetë përfshirë në veprimtari të kundërligjshme, shfaqur në formën e shpërdorimit të detyrës, dhe konkluzioni mbetet në vlerësimin e Komisionit.

3.3 KLP, bazuar në nenin 43, pika 2, të ligjit nr. 84/2016, në përfundim të rishikimit të dokumenteve ligjore të përpiluara nga subjekti, gjatë periudhës objekt i rivlerësimit, ka përcjellë pranë Komisionit raportin për analizimin e aftësive profesionale të subjektit.

4. Përfundimet e Komisionit për secilin kriter kontrolli, në mënyrë të përmbledhur, janë si vijon:

4.1 ***Për vlerësimin e pasurisë.*** Trupi gjykues ka arritur në konkluzionin se pasaktësitë e konstatuara, si dhe balanca financiare negative prej 407.722 lekësh, bazuar në parimin e proporcionalitetit dhe në një vlerësim tërësor të rrethanave, janë të karakterit minimal dhe nuk vlerësohen se arrijnë deri në atë masë sa që ndaj subjektit të rivlerësimit të aplikohet masa disiplinore e shkarkimit nga detyra, bazuar në pikën 3, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016. Komisioni ka vlerësuar se subjekti i rivlerësimit ka arritur një nivel të besueshëm për kriterin e vlerësimit të pasurisë, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin D të aneksit të Kushtetutës.

4.2 ***Për kontrollin e figurës.*** Trupi gjykues arriti në përfundimin se të dhënat e referuara në raportin e DSIK-së nuk provojnë implikimin e subjektit të rivlerësimit në veprime të paligjshme me natyrë korruptive, ndikim të paligjshëm apo kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar (në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë). Komisioni vlerësoi se subjekti i rivlerësimit ka arritur një nivel të besueshëm për kriterin e figurës dhe sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të aneksit të Kushtetutës, duke konfirmuar përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës.

¹ Raporti nr.*** prot., datë **.10.2017, deklasifikuar plotësisht me vendim të KDZH-së nr. *** prot., datë **.10.2021.

² Raporti nr.*** prot., datë **.3.2022, deklasifikuar pjesërisht me vendim të KDZH-së nr. ** prot., datë **.3.2022.

4.3 **Për vlerësimin e aftësive profesionale.** Trupi gjykues ka vlerësuar se, në bazë të të gjitha rrethanave, kushteve, fakteve dhe shpjegimeve të subjektit, si më sipër, bazuar në analizën e vlerësimit të aftësive profesionale të kërkuar nga germa “c”, e pikës 1, të nenit 59, të ligjit nr. 84/2016, çmon se problematikat e konstatuara në veprimet apo mosveprimet procedurale të subjektit, për mënyrën se si subjekti ka performuar në raport me të drejtën dhe legjislacionin, në ushtrimin e detyrës së tij si prokuror, janë të karakterit minimal, të cilat nuk arrijnë deri në atë nivel sa ndaj subjektit të aplikohet masa disiplinore e shkarkimit nga detyra, bazuar në pikën 4, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016.

5. Nisur nga përfundimet e mësipërme, trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, në bazë të nenit 58, pika 1, germa “a” dhe nenit 59, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, pasi konstatoi se subjekti ka arritur një nivel të besueshëm të vlerësimit të pasurisë, një nivel të besueshëm të kontrollit të figurës, si dhe një nivel të mirë kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale, me shumicë votash, ndër të tjera, ka vendosur: [...] *Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, z. Florian Bonjaku, me funksion prokuror në Prokurorinë pranë Rrethit Gjyqësor, Krujë [...].*

II. Vlerësimi i Komisionerit Publik

6. Në kuptim të nenit 179/b të Kushtetutës, aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, Komisioneri Publik është një nga tri institucionet e ngarkuara për kryerjen e procesit të rivlerësimit kalimtar (Vetting).

7. Bazuar në këto parashikime kushtetuese dhe ligjore, Komisionerit Publik, si përfaqësues i interesit publik në kryerjen e këtij procesi, i njihet e drejta e ankimit kundër vendimeve të Komisionit dhe paraqitjen e tyre juridiksionit rivlerësues të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit (në vijim referuar si Kolegji).

8. Në krahasim me kompetencat kushtetuese dhe ligjore që u njihen Komisionit dhe Kolegjit nga neni Ç, i aneksit të Kushtetutës dhe nenet 48-52, të ligjit nr. 84/2016, Komisioneri Publik është i detyruar që kompetencën e tij për të ushtruar ankim ndaj vendimeve të Komisionit, ta mbështesë vetëm në aktet dhe provat e administruara gjatë kryerjes së procesit të rivlerësimit nga ana e Komisionit.

9. Në të tilla rrethana ligjore, me qëllim garantimin e mbrojtjes së interesit publik gjatë procesit të rivlerësimit, Komisioneri Publik ka detyrimin që të ushtrojë kontroll mbi vendimet e dhëna nga Komisioni, duke vlerësuar nëse vendimmarrja e tij është në përputhje me kërkesat kushtetuese e ligjore, bazohet në një hetim administrativ të gjithanshëm e shterues, vlerësim të drejtë të provave, si dhe në përputhje me jurisprudencën orientuese të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit.

10. Edhe në rastin konkret, Komisioneri Publik, mbështetur në kompetencën e tij kushtetuese dhe ligjore, konstaton se, nga shqyrtimi i vendimit nr. 537/2022, të Komisionit dhe akteve shoqëruese të tij, duke analizuar konstatimet për secilin nga kriteret e vlerësimit, në kuptim të nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, paraqiten gjetje dhe rrethana të tilla ligjore e fakti, të cilat e bëjnë të cenueshëm në tërësinë e tij dhe përmbajnë shkaqe të mjaftueshme ligjore për t’u paraqitur për shqyrtim, nëpërmjet ankimit, juridiksionit kontrollues dhe rivlerësues të Kolegjit.

11. Për sa më sipër, bazuar në nenin C, pika 2, nenin F, pikat 3 dhe 7, të aneksit të Kushtetutës si dhe nenit 4 dhe 66, të ligjit nr. 84/2016, ky ankim i Komisionerit Publik ndaj vendimit nr. 537, datë 2.6.2022, të Komisionit, ushtrohet në vlerësimin e të tri kriterëve të rivlerësimit.

III. Analiza e shkaqeve të ankimit

III.A. Lidhur me gjetjet në kontrollin e pasurisë

12. Interesat privatë dhe pasurorë, të deklaruar nga subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të, janë deklaruar fillimisht në “Deklaratën e personit, që mbart detyrimin për deklarim pasurie”, dorëzuar në ILDKPKI më datë 31.3.2004, dhe në vijim në deklaratat periodike për vitet 2004 - 2016 (këtu e në vijim referuar si DV-20...) dhe në Deklaratën “Vetting” (këtu e në vijim referuar si D-Vett.), dorëzuar në ILDKPKI në datën 25.1.2017.

13. Nga shqyrtimi dhe krahasimi i deklaratave si më sipër, referuar nenit 32, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, në funksion të nenit D, të aneksit të Kushtetutës, konstatojmë sa në vijim:

13.1 Në D-Vett., subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: [...] *Apartament me sip. 62,95 m², L. **, rr. “*** **”, Durrës, blerë me kontratë shitje pasuri të paluajtshme me nr. *** rep., nr. *** kol., datë **.6.2003, në vlerën 100.000 lekë. Këtë apartament ia kam blerë jo realisht, vetëm për qëllim dokumentacioni (fiktivisht) prindërve të bashkëshortes sime. Ky apartament është blerë vetëm për arsye dokumentacioni, me qëllim për të bërë të mundur marrjen e një kredie në Bankën *** **, me qëllim blerjen e apartamentit në blv. “*** **”, Tiranë (i shpjeguar më poshtë), pasi banka nuk jepte kredi nëse shtëpia që do të blihej, ishte e peregjistruar në ZRPP dhe ky apartament ishte në ndërtim e sipër. Kjo shtëpi nuk është zotëruar kurrë nga unë, por është zotëruar dhe zotërohet nga prindërit e bashkëshortes sime të cilët jetojnë aty pa asnjë ndërprerje, që nga viti 1996, kur është blerë nga prindërit e bashkëshortes[...].*

13.1.1 Në D-Vett., subjekti i rivlerësimit, gjithashtu, ka deklaruar: [...] *Apartament banimi sip. 112,4 m² ndodhur në pallatet “***”, lagjja “*** **”, Tiranë. Vlera: 8.948.000 lekë. Pjesa takuese: në bashkëpronësi me bashkëshorten. Ky apartament është blerë në datën **.11.2011 (në vlerën 8.948.000 lekë), me lekët e përfituara nga shitja e një apartamenti me sip. 69,4 m² ndodhur në blv. “*** **”, Tiranë, i cili është shitur në datën **.8.2011, për vlerën 9.500.000 lekë. Ky apartament (69,4 m²) është blerë me dt. **.5.2004, në vlerë 19.432 USD, por realisht ishte prenotuar që në vitin 2003, kur ende ishte në fazën e ndërtimit. Si burim ka shërbyer kredia nga *** në shumën 20.000 USD, për një afat 15-vjeçar. Kolateral për këtë kredi, fillimisht, është lënë apartamenti në rrugën “*** **”, Durrës. Sapo apartamenti në blv. “*** **”, është regjistruar në ZRPP, është ndryshuar kolaterali i kësaj kredie dhe është vënë si kolateral ky apartament [...].*

13.2 Në DV-2003, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: [...] *Apartament banimi, ndërtuar para vitit 1990, me sip. 75 m², në lagjen “*** **”, Durrës. Vlera: 3.500.000 lekë. Pjesa takuese: ½. Burim krijimi: Kredi pranë Bankës *** ** (***), Tiranë [...]. Në të njëjtën deklaratë, në rubrikën: “Detyrimet financiare ndaj personave fizikë dhe juridikë”, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: [...] *Marrë kredi në shumën 2.700.000 lekë, pranë Bankës *** **, për blerje shtëpie banimi [...].**

13.3 Në DV-2004, subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar pronësinë mbi apartamentin me sip. 69,4 m², me adresë blv. “**** ****”, Tiranë³, vlerën dhe burimin e krijimit të saj, si dhe nuk ka deklaruar detyrimet financiare lidhur me kredinë bankare 20.000 USD, marrë pranë ****.

13.4 Në DV-2005, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: [...] *Kredi bankare për blerje shtëpie në shumën 20.000 USD, me afat 15-vjeçar ... marrë pranë **** Bank [...]* (duke deklaruar shumën e paguar dhe detyrimin e mbetur).

13.5 Në DV-2006, subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar detyrimet financiare lidhur me kredinë bankare 20.000 USD, marrë pranë ****.

13.6 Në DV-2007, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: [...] *Kredi bankare për blerje shtëpie tek ****, në vlerën 20.000 USD, datë fillimi prill 2003 - prill 2018, kohëzgjatja 15 vjet, kësti 200 \$[...]* (duke deklaruar shumën e paguar dhe detyrimin e mbetur).

13.7 Në deklaratat periodike vjetore për vitet 2008, 2009 dhe 2010, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: [...] *Kredi bankare për blerje apartament banimi, rr. “**** ****”, blv. “**** ****”, në shumën 20.000 USD, me interes 5,9% [...]* (duke deklaruar shumën e paguar dhe detyrimin e mbetur).

13.8 Në DV-2011 subjekt i rivlerësimit ka deklaruar: [...] *Shitje apartamenti me sip. 69,4 m², me nr. pasurie ****, vol. **, f.****, z. k. ****, me adresë blv. “**** ****”, shitur në vlerën 9.500.000 lekë, sipas aktit noterial nr. **** rep., nr. **** kol., datë **.8.2011⁴[...]*.

(i) ILDKPKI në “Aktin e përfundimit të kontrollit të plotë të pasurisë për subjektin e rivlerësimit⁵”, ndër të tjera, ka konstatuar [...] (i) *Deklarime të paqarta dhe kontradiktore lidhur me apartamentin me sip.75 m², në rrugën “**** ****”, Durrës, apartamentin me sip. 69.4 m², në rrugën “**** ****”, Tiranë, dhe burimin e krijimit për blerjen e tyre me kredi në ****; (ii) Mospërputhje e vlerës së apartamentit me sip. 75 m² në Durrës, pasi në deklaratën “Para fillimit të detyrës 2003” është deklaruar 3.500.000 lekë, sipas Deklaratës “Vetting” dhe kontratës së shitblerjes datë **.6.2003, paraqitur nga subjekti, apartamenti ka vlerën 100.000 lekë. Rezulton se për blerjen e apartamentit janë kryer dy kontrata shitblerje (me qëllim përfitimin e kredisë); (iii) Mosdeklarim në deklaratat e interesave privatë “Para fillimit të detyrës 2003” dhe “Periodike vjetore 2004” të apartamentit në blv. “**** ****”, blerë nga subjekti me kontratë shitblerje datë **.5.2004 dhe vlerë 19.432 dollarë, por i prenotuar që në vitin 2003 (sipas deklaramit Vetting); (iv) Mospërputhje lidhur me përdorimin e fondeve të*

³ Vërtetim nga dokumentet hipotekore – ZVRPP Tiranë, me nr. **** regj., dt. **.5.2004, ku vërtetohet regjistrimi i titullit të pronësisë për subjektin e rivlerësimit.

⁴ Shitja e pasurisë apartament banimi me adresë blv. “**** ****” ka shërbyer si burim për blerjen e pasurisë me adresë rr. “**** ****”. Lidhur me transaksionin e shitjes, Komisioni ka konstatuar dhe i ka kaluar subjektit barrën e provës për sa më poshtë: [...] *Duket se ka dyshime për veprime fiktive, me qëllim justifikimin e të ardhurave të përfituara nga shitja e apartamentit 69,4m² nga subjekti i rivlerësimit, për arsye se: - nuk provohet me dokument ligjor përcaktimi i vlerës së rivlerësimit në shumën 9,543,800 lekë (mungesa e aktit të rivlerësimit nga ekspertit) dhe arsyet që kanë çuar në arritjen e kësaj vlere, e cila krijon një diferencë të theksuar prej 3,436,600 lekë, krahasuar me çmimin e tregut 6,107,200 lekë (llogaritur nga ASHK); - nuk provohet me dokument ligjor marrja e shumës 9,500,000 lekë nga subjekti; - shitja e apartamentit 69.4m² në 2013 (pas dy vitesh), nga blerësi ****.**** në vlerën 44,000 euro ose 6,225,120 lekë (çmim i përfaqësuar me çmimin e referencës së shitjes së apartamenteve në këtë zonë) ka një diferencë të theksuar me shitjen e vitit 2011 nga subjekti, në vlerën 9,500,000 lekë [...]. Gjithashtu, nga aktet e hetimit administrative rezulton të jetë konstatuar se: [...] Komisioni ka administruar përgjigjen e Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar (në vijim GJPKKO), e cila konfirmon se kjo gjykatë ka dhënë vendimin nr.**, datë **.2.2014 për shtetasin **** **** (quajtur ndryshe ****.****) me objekt “çaktim mase sigurimi”, ajo e arrestit me burg, pasi ekziston dyshimi i arsyeshem i bazuar në prova që shtetasi ****.**** ka kryer veprën penale të “trafikimit të femrave”, të parashikuar nga neni 114/b i K. Penal [...].*

⁵ Referohuni Raportit të ILDKPKI-së nr. ****/** prot., datë **.7.2019.

kredisë në *** Bank, deklaruar në deklarinimin "Para fillimit të detyrës 2003" dhe në kontratën e kredisë, datë **.6.2003, për blerjen e apartamentit në Durrës, ndërkohë që në deklarinimin Vetting deklarohet se fondet janë përdorur për blerjen e apartamentit në Tiranë [...].

14. Sa më sipër, në dosje të Komisionit, gjatë hetimit administrativ, ndër të tjera, janë administruar aktet si vijon:

(i) Kontratë shitje e pasurisë së paluajtshme nr. *** rep., nr. *** kol., datë **.6.2003, me palë shitëse z. ***.*** (vjehri i subjektit) dhe palë blerëse subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur. Objekt kontrate është shitja e apartamentit me sip. 62,95 m² ndodhur në rr. "****.***", Durrës, me çmim 100.000 lekë.

(ii) Shkresë nr. *** prot., datë **.6.2020 e ASHK-së, Durrës, që konfirmon se apartamenti me sip. 62,95 m² ndodhur në rrugën "****.***", Durrës, rezulton në pronësi të subjektit të rivlerësimit dhe personit të lidhur të tij.

(iii) Kontratë Kredie dhe vënie në hipotekë nr. *** rep., nr. *** kol., datë **.6.2003, ndërmjet *** Bank, në cilësinë e kredihënësit dhe subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur, në cilësinë e kredimarrësve. Në nenin 1 të kësaj kontrate parashikohet se banka do t'u japë kredimarrësve një kredi në shumën 20.000 USD, me qëllim blerjen e një apartamenti në Durrës, sipas kontratës së shitblerjes nr. *** rep., nr.*** kol., datë **.3.2003.

(iv) Kontratë porosie e panoterizuar, datë **.7.2003, me palë sipërmarrëse shoqërinë "****.***" sh.p.k., dhe palë porositëse subjekti i rivlerësimit, sipas së cilës sipërmarrësi merr përsipër që t'i ndërtojë porositësit një apartament me sipërfaqe totale 72 m², me çmim 19.432 USD, me adresë blv. "****.***", Tiranë.

(v) Kontratë shitblerje pasurie të paluajtshme nr. *** rep., nr. *** kol., datë **.5.2004, me pale shitëse shoqërinë "**** - ***" sh.p.k. dhe palë blerëse subjekti i rivlerësimit. Objekt kontrate është një apartament me sip. 69,4 m², në blv. "****.***", Tiranë, me çmim shitje 19.432 USD, i likuiduar tërësisht jashtë zyrës noteriale.

(vi) Vërtetim hipotekor me nr. ***, datë **.5.2004, me anë të së cilit vërtetohet se në Regjistrin hipotekor rezulton e regjistruar në pronësi të subjektit të rivlerësimit pasuria apartament me sip. 69,4 m², ndodhur në blv. "****.***".

(vii) Kontratë hipoteke nr. *** rep., nr. *** kol., datë **.6.2005, ndërmjet *** Bank, në cilësinë e përfituesit dhe subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur, në cilësinë e hipotekuesve. Qëllimi dhe objekti i kësaj kontrate është hipotekimi në favor të bankës i pasurisë *apartament me sip. 69,4 m²* ndodhur në blv. "****.***", Tiranë, me nr. pasurie ***, me qëllim sigurimin e kredisë së marrë në vitin 2003, në shumën 20.000 USD, me anë të së cilës subjekti ka ndryshuar kolateralin, duke hequr nga barra hipotekore apartamentin në rr. "****.***" dhe duke e zëvendësuar atë me *apartamentin* në blv. "****.***".

15. Komisioni ka konstatuar se në kontratën e kredisë nr. *** rep., nr. *** kol., datë **.6.2003, referohet: [...] *se kredia do të jepej për blerjen e apartamentit sipas kontratës së shitblerjes me nr. *** rep., nr. *** kol., datë **.3.2003* [...], që është e ndryshme nga kontrata e deklaruar dhe depozituar nga subjekti në Deklaratën "Vetting" (kontratë e datës **.6.2003). Sa më sipër, pasi ka rezultuar se për apartamentin me sip. 62,95 m² ndodhur në qytetin e Durrësit janë nënshkruar dy kontrata noteriale shitblerje me ekstremitete të ndryshme, në Pyetësorin nr. 2, Komisioni i ka kërkuar subjektit të depozitojë kontratën e shitblerjes nr. *** rep., nr. *** kol., datë **.3.2003, të cituar në kontratën e kredisë bankare.

15.1 Në përgjigje të sa më sipër, subjekti ka deklaruar: [...] *Nisur nga koha e gjatë e kaluar, nuk e disponoj një dokument të tillë. Sikurse jua kam shpjeguar edhe më lart, te përgjigjja e pyetjes nr. 1, kontrata e shitblerjes që unë disponoj për këtë banesë është kontrata me nr. *** rep. e nr. *** kol., datë **.6.2003 [...].*

15.2 Në përgjigje të kërkesës së Komisionit, noterja ***.*** me shkresën nr. *** prot., datë **.12.2021, i ka përcjellë Komisionit, kontratë shitje me rezervë me nr. *** rep., nr. *** kol., datë **.3.2003, me pale shitëse z. ***.*** dhe palë blerëse subjekti i rivlerësimit, për apartamentin me sip. 62,95 m², ndodhur në rr. “****.***”, Durrës, me vlerë 30.000 USD⁶.

15.3 Në përfundim të hetimit administrativ, Komisioni për pasuritë *apartament me sip. 62,95 m²* ndodhur në Durrës dhe *apartament me sip. 69,4 m²* ndodhur në blv. “****”***, Tiranë, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, i ka kaluar subjektit të rivlerësimit barrën e provës lidhur me sa vijon: [...] (i) *Duket se ka mospërputhje deklarimi për burimin e krijimit të apartamentit 62,95 m² ndodhur në rr. “****.***”, pasi në deklaratën e 2003, subjekti deklaroi si burim krijimi “Kredi tek ***”, ndërkohë që në Vetting deklaroi se nuk ka paguar vlera monetare; kredia është disbursuar datë **.6.2003, më pas se është blerë apartamenti më datë **.6.2003; (ii) Duket se subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar kontratën e shitjes me rezervë datë **.3.2003, që pasqyron çmimin 30.000 USD, të përdorur për marrjen e kredisë, në deklaratat 2003 – 2016 dhe atë Vetting; (iii) Duket se kemi të bëjmë me veprime fiktive të kryera (më shumë se një herë) nga subjekti i rivlerësimit në paraqitjen e dy kontratave me referenca dhe çmime të ndryshme për apartamentin me sip. 62,95 m² për përfitimin e kredisë, veprime këto që duket se subjekti ndodhet në kushtet e cenimit të besimit të publikut të sistemi i drejtësisë; (iv) Duket se subjekti i rivlerësimit nuk e ka deklaruar apartamentin 69,4 m² në deklaratën e vitit 2003, vit kur është lidhur kontrata e porosisë, nuk e ka deklaruar në DIPP e vitit 2004, kur është lidhur kontrata e shitjes dhe nuk e ka deklaruar as në DIPP 2005-2010 [...].*

15.4 Subjekti i rivlerësimit, në përgjigje të barrës së provës, duke mbajtur të njëjtin qëndrim si në përgjigje të pyetësorëve gjatë hetimit administrativ, ndër të tjera, ka deklaruar: [...] *Për sa i përket konstatimit në dukje se subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar kontratën e shitjes me rezervë, datë **.3.2003, që pasqyron çmimin 30.000 USD, të përdorur për marrjen e kredisë, në deklaratat 2003 – 2016 dhe atë Vetting, kam shpjeguar dhe detajuar në përgjigje të Pyetësorit nr. 3, të dërguar nga Komisioni, faktin se: Kontrata e Shitjes me rezervë nr. *** rep. dhe nr. *** kol., datë **.3.2003, hartuar nga notere ***.***, është sjellë në vëmendjen time vetëm pas pyetjeve të Komisionit dhe pasi jam interesuar te zyra e noteres për këtë kontratë dhe praktikën e saj, ka rezultuar pikërisht sa ju kam shpjeguar dhe detajuar më lart, në lidhje me qëllimin e kryerjes së këtij veprimi juridik, i cili nuk ishte tjetër, përveçse mundësimi i blerjes së apartamentit në qytetin e Tiranës, i ndodhur në blv. “**** ***”...Pasaktësia në deklarime, lidhur me momentin e deklarimit të kësaj pasurie, e cila siç rezulton, nuk ka sjellë asnjë pasojë dhe madje është kontrolluar edhe nga ILDKPKI, duke mos u konstatuar asnjë veprim në kundërshtim me ligjin specifik dhe, rrjedhimisht, pa ekzistuar penalizimi i subjektit të deklarimit, nuk duhet të interpretohet si mosdeklarim, pasi qartazi provohet se është*

⁶ Objekt kontrate është shitja e apartamentit me sip. 62,95 m² ndodhur në lagjen **, rr. “****.***”, Durrës. Në këtë kontratë specifikohet se çmimi i pasurisë është 30.000 USD dhe do të paguhet me këste si vijon: (i) *kësti i parë prej 10.000 USD është paguar nga ana e blerësit në datën e nënshkrimit, jashtë zyrës noteriale, ndërsa (ii) kësti i dytë prej 20.000 USD do të paguhet nga blerësi, i cili ka aplikuar për kredi pranë Bankës ***.***.*

deklaruar si adresa e banimit, ashtu edhe kredia që është përdorur për blerjen e apartamentit të ndodhur në bulevardin “*** **”, Tiranë [...].

15.5 Komisioni, në përfundim për sa më sipër, ka vlerësuar se: [...] *Subjekti i rivlerësimit ka dhënë shpjegime të mjaftueshme në lidhje me kontratat e shitjes të lidhura me prindërit e bashkëshortes. Nga hetimi administrativ ka rezultuar i provuar se qëllimi i vetëm i këtyre kontratave ka qenë marrja e kredisë dhe jo kalimi i pronësisë së këtij apartamenti...në lidhje me mosdeklarimin e apartamentit me sip. 69,4 m² në deklaratën e pasurisë të vitit 2003 dhe 2004, që korrespondon përkatësisht me kohën e lidhjes së kontratës së sipërmarrjes dhe atë të shitblerjes së këtij apartamenti, si dhe mosdeklarimin e tij deri në vitin 2010, mban në konsideratë faktin se Deklarata “Vetting” është dokumenti ligjor bazë, në të cilën Komisioni bazon procesin e rivlerësimit të subjekteve të rivlerësimit në lidhje me kriterin e pasurisë...Për rrjedhojë, Komisioni vlerëson se mosdeklarimi i pasurisë apartament me sip. 69,4 m², në deklaratat e pasurisë të vitit 2003, 2004, të konsiderohet si një pasaktësi në deklaram, e cila, e parë ndërthurur me deklarimin e shitjes së këtij apartamenti në DIPP-në e vitit 2011, me deklarimin me vërtetësi të historikut të këtij apartamenti, si dhe të destinacionit të shumës së përfituar nga shitja e tij, në Deklaratën “Vetting”, merr një peshë minimale, jo deri në atë masë sa që të mund të penalizojë subjektin e rivlerësimit për sa i përket vlerësimit të kriterit të pasurisë [...].*

16. Komisioneri Publik, në analizë të situatës faktike të përshkruar më sipër, për pasuritë apartament me sip. 62,95 m² ndodhur në Durrës dhe apartament me sip. 69,4 m² ndodhur në blv. “*** **”, Tiranë, vlerëson se përfundimi i arritur nga Komisioni nuk është i mbështetur në provat e administruara dhe ligjin e zbatueshëm, për sa vijon:

16.1 Në analizë të deklarameve periodike të subjektit të rivlerësimit për vitet 2003-2016, si dhe të shpjegimeve të dhëna prej tij para Komisionit, rezultojnë deklarame kontradiktore lidhur me çmimin e blerjes dhe burimin e krijimit, për pasurinë apartament me sip. 62,95 m² në Durrës. Për më tepër, përveç kontratës noteriale të shitjes, datë **.6.2003, që pretendohet se nuk ka krijuar pasoja juridike *de facto*, të deklaram nga vetë subjekti i rivlerësimit si titull pronësie i kësaj pasurie, ka rezultuar se vetë subjekti i rivlerësimit ka lidhur edhe një kontratë tjetër noteriale, datë **.3.2003, kontratë që ka shërbyer për marrjen e kredisë, kontratë të cilën nuk e ka deklaram në deklaramet periodike vjetore dhe as gjatë hetimit administrativ.

16.1.1 Subjekti i rivlerësimit rezulton se ka kryer deklaram të pamjaftueshëm edhe në D-Vett., duke mos deklaram edhe në këtë rast, ekzistencën e kontratës të datës **.3.2003, që ka shërbyer për përfitimin e kredisë në vlerën e dëshiruar, duke mos sqaruar dhe duke krijuar pamundësi në verifikimin e rrethanave ligjore dhe faktike mbi pronësinë dhe burimin e këtyre pasurive. Nga dokumentacioni ligjor rezulton se subjekti i rivlerësimit vazhdon të jetë pronar *de jure* i apartamentit me sip. 62,95 m² me adresë në Durrës, me gjithë faktin se është hequr barra hipotekore e nevojshme për sigurimin e kredisë pranë ***-së që në vitin 2005, pasi apartamenti, me adresë blv. “*** **”, është regjistruar në pronësi të subjektit të rivlerësimit në ZVRPP, në maj të vitit 2004.


16.2 Lidhur me apartamentin me sip. 69,4 m² ndodhur në blv. “*** **”, Tiranë, subjekti i rivlerësimit, për periudhën 2003 - 2010, nuk ka deklaram të drejtat reale sipas kontratës së sipërmarrjes të lidhur në vitin 2003, titullin e pronësisë të fituar, e regjistruar në maj 2004, në përmbushje të detyrimeve që rrjedhin nga ligji nr. 9049/2003. Në D-Vett., kredia prej 20.000 USD nga *** është deklaram si burim për krijimin e apartamentit në blv. “*** **”, Tiranë,









ndërkohë në DV-2003 kjo kredi, nga subjekti i rivlerësimit deklarohet si burim për krijimin e apartamentit me adresë rr. “***.***”, Durrës.

16.3 Komisioneri Publik konstaton se subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar me saktësi dhe vërtetësi në D-Vett., rrethanat faktike dhe ligjore mbi pasuritë në posedim apo pronësi të tij, si dhe ka kryer deklarime të pasakta dhe të pamjaftueshme në deklaratimet periodike vjetore. Komisioneri Publik, në konsideratë dhe të jurisprudencës së Kolegjit, vëren se legjislacioni në fuqi ka qenë i qartë edhe në drejtim të rrjedhëve ligjore për subjektet lidhur me deklaratimet sipas ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003. Për këtë arsye, neni 32, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, u ka njohur vlerën e provës, deklaratave periodike të pasurisë. Këto deklaratata, së bashku me provat e tjera, vlerësohen në tërësi me rrethanat e çështjes, për të arritur në një konkluzion sa më të drejtë për vlerësimin e kriterit të pasurisë.

16.4 Në këto rrethana, Komisioneri Publik, vlerëson se mosdeklarimet e pasurisë ndër vite, veprimet juridike të kryera për dukje⁷, si dhe deklaratimet e pasakta dhe kontradiktore të mësipërme vijnë ndesh me sjelljen që pritet nga një magjistrat dhe, si pasojë, subjekti i rivlerësimit gjendet në situatën ku duket se ka cenuar besimin e publikut, në kuptim të nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, në përpjekje për të pasqyruar në mënyrë të pamjaftueshme e të pasaktë pasuritë në pronësi të tij në përputhje me nenin D të aneksit të Kushtetutës.

III.B. Lidhur me gjetjet në raportin e DSIK-së

17. Gjatë hetimit për kontrollin e figurës, DSIK-ja, pas kërkesës së Komisionit për rishikim dhe deklasifikim të raportit fillestar, ka përcjellë pranë Komisionit, me shkresën nr. *** prot., datë **.3.2022, Raportin mbi kontrollin e figurës për subjektin e rivlerësimit, në të cilin informohet se: [...] 

17.1 Komisioni, nisur nga informacioni i përcjellë nga organet ligjzbatuese, ndër të tjera, ka administruar përgjigjen e Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor, Krujë⁸, e cila ka vënë në dispozicion fashikullin e procedimit penal nr. ***/2019.

17.2 Procedimi penal nr.*, datë **.5.2019**

17.2.1 Mbi bazën e materialit kallëzues, të përcjellë nga Komisariati i Policisë Krujë, Prokuroria e Rrethit Gjyqësor, Krujë, më datë **.5.2019, ka regjistruar procedimin penal për veprën penale të “Kultivimit të bimëve narkotike”⁹, parashikuar nga neni 284/2 i K. Penal, ndër të tjerë, në ngarkim dhe të shtetasve *** dhe ***.***. Nga subjekti i rivlerësimit, në cilësinë e prokurorit të çështjes, rezulton se është urdhëruar regjistrimi në regjistrin e veprave penale të këtyre shtetasve për kryerjen e veprës penale të parashikuar në nenin 284/2 të K. Penal.

⁷ Referohuni vendimit të Kolegjit (JR) nr. 10/2021, prg.11.

⁸ Referohuni shkresave kthim përgjigje nr.*** prot., datë **.1.2022, dhe nr. ** prot., datë **.1.2022, të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor, Krujë.

⁹ Në një fshat të Krujës janë zbuluar parcela të mbjella me lëndë narkotike të llojit *cannabis sativa*.

17.2.2 Mbi bazën e dyshimeve të arsyeshme është vendosur ndalimi i shtetasit ***.*** dhe ***.***, dhe nga subjekti i rivlerësimit është kërkuar caktimi i masës së sigurimit personal “Arrest në burg”, pasi ishin verifikuar kushtet dhe kriteret ligjore për këta shtetas, si subjekte të kryerjes së veprës penale, të parashikuar nga neni 284/2 i K. Penal.

17.2.3 Në kërkesat e përpiluara nga subjekti i rivlerësimit, në cilësinë e prokurorit të çështjes, deri në këtë fazë të hetimit, është verifikuar si pjesë e akteve procedurale edhe transkripti i një shkëmbimi të SMS-së që shtetasi ***.*** i dërgon një numri tjetër me tekst: [...] *Ej aman shko me *** ke ato të mijat, shtrijni tubat, se të kallzo ***. Hudhni 20-20, ene ujitni pak mirë se e kam mamën petë. S'mun lëviz prz e madh me vdek se është me tension 22* [...].

17.2.4 Për një periudhë prej rreth 8 muajsh, dy shtetasit e mësipërm janë hetuar nga subjekti i rivlerësimit, si autorë të dyshuar të kryerjes së veprës penale të “Kultivimit të bimëve narkotike”, të parashikuar nga neni 284/2 i K. Penal.

17.2.5 Në janar 2020 e në vijim, hetimet për shtetasit *** dhe ***.*** janë orientuar kah kryerjes së veprës penale të “Moskallëzimit të krimit” parashikuar nga neni 300 i K. Penal. Gjatë hetimit administrativ është verifikuar se në vijim të veprimeve procedurale, prej këtij momenti kohor, transkripti i shkëmbimit të SMS-së që ***.*** i dërgon një numri tjetër pasqyrohet në akte me një përmbajtje tjetër, të reduktuar: [...] *Ej aman shko me *** atje se s'mun lëviz prz e madh me vdek se është me tension 22* [...].

17.2.6 Në datë **.4.2020, subjekti i rivlerësimit, në cilësinë e prokurorit të çështjes, ka depozituar në gjykatën kompetente kërkesën për dërgimin për gjykim të të pandehurve të tjerë, akuzuar për veprën penale të “Kultivimit të lëndëve narkotike”, të parashikuar nga neni 284/2 i K. Penal, ndërsa për shtetasit ***.*** dhe ***.*** është kërkuar dërgimi për gjykim për veprën penale të “moskallëzimit të krimit”, të parashikuar nga neni 300 i K. Penal.

17.2.7 Gjykata e Rrethit Gjyqësor, Krujë, me vendimin nr. *** akti, datë **.5.2020, ka vlerësuar se kërkesa e Prokurorisë është pjesërisht e bazuar në ligj dhe në prova, duke vendosur të pranojë kërkesën për dërgimin për gjykim të procedimit penal nr. ***/2019, në ngarkim të shtetasve ***.***, ***.***, ***.*** dhe ***.***, për veprën penale të “Kultivimit të lëndëve narkotike”, parashikuar nga neni 284/2 i K. Penal. Gjykata ka vendosur kthimin për rihetim për të subjektet ***.*** (***), ***.***, ***.***, ***.***, ***.***, pasi ka vlerësuar se hetimi nuk është i plotë për arsye se procedimi penal ndaj këtyre shtetasve ka nisur pasi kanë qenë të dyshuar se kanë kryer veprën penale të parashikuar nga neni 284/2 i K. Penal, kryer në bashkëpunim. Sipas gjykatës, në kërkesën për dërgimin për gjykim, subjekti i rivlerësimit nuk argumenton me prova, arsyet ligjore të ndryshimit të këtij kualifikimi nga neni 284/2 në nenin 300 të K. Penal. Gjykata ka arsyetuar se hetimi ndaj këtyre shtetasve do të duhet të vijojë në disa drejtime dhe ka lënë detyra që duhet t'i kryejë Prokuroria.

17.2.8 Rezulton se subjekti i rivlerësimit ka ankimuar vendimin nr. *** akti, datë **.5.2020, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Krujë, duke arsyetuar mbi panevojshmërinë e kryerjes së veprimeve të tjera hetimore dhe duke kërkuar, ndër të tjera, dhe ndryshimin e këtij vendimi dhe pranimin e kërkesës së organit të Prokurorisë për dërgimin në gjyq të çështjes në ngarkim të të pandehurve ***.*** dhe ***.***, për veprën penale “Moskallëzim krimi”, të parashikuar nga neni 300 i K. Penal.

17.2.9 Ndërkohë, Prokurori pranë Gjykatës së Apelit, Tiranë, në bisedimet përfundimtare mbi ankimin e paraqitur nga subjekti i rivlerësimit, kundër vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Krujë, ka hequr dorë nga ankimi i depozituar nga subjekti i rivlerësimit, duke referuar se: [...] *argumentet mbi panevojshmërinë e kryerjes së këtyre veprimeve nga ana e prokurorit nuk i gjen të bazuara, pasi referuar akteve të hetimeve paraprake rezulton se hetimi*

ka qenë i paplotë dhe jo i gjithanshëm, ekzistojnë dyshime të bazuara se këta persona kanë qenë të përfshirë në veprimtarinë kriminale, dyshim i cili ka çuar prokurorin të kërkojë edhe caktimin e masave të sigurimit kundrejt këtyre personave, dyshim i cili nuk është qartësuar, në aspektin e fajësimit ose shfajësimit, me veprimtari të mëtejshme hetimore dhe të gjithanshëm [...]. Në të tilla rrethana ligjore, Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. ***, datë **.7.2020, ka vendosur mospranimin e ankimit ndaj vendimit nr. *** akti, datë **.5.2020, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Krujë, për shkak heqje dorë nga ankimi.

17.2.10 Në datën **.3.2021, bazuar në përfundimet e nxjerra nga kryerja e veprimeve procedurale të lëna si detyrë nga ana e gjykatës, subjekti i rivlerësimit ka dërguar përsëri kërkesën për gjykim dhe ka relatuar se, pas veprimeve hetimore, nuk kanë rezultuar të dhëna, që mund të ndryshonin cilësimin juridik të veprës së kryer nga shtetasit ***.*** dhe ***.***.

17.2.11 Në aktin përkatës, subjekti i rivlerësimit parashtron se nga veprimet hetimore nuk është bërë e mundur dokumentimi me prova ligjore i faktit se personi nën hetim ***.*** ka konsumuar elementet e veprës penale, të parashikuar nga neni 284/2 i K. Penal. Sipas subjektit të rivlerësimit, nga transkriptimi i bisedave dhe provave të tjera të marra, rezultoi e provuar se nuk mund të provohej bashkëpunimi i këtij shtetasi në kultivimin e bimëve narkotike, por ka rezultuar se kanë dijeni në lidhje me bimët narkotike të kultivuara nga shtetasi ***.***, në fshatin ***, gjë e cila vërtetohet nga biseda që ka zhvilluar me këtë shtetas me datë **.5.2019, dhe nisur nga fakti se nuk e ka kallëzuar një fakt të tillë rezultoi se ka konsumuar veprën penale të “Moskallëzimit të krimit”, parashikuar nga neni 300 i K. Penal.

17.2.12 Në kërkesën për dërgimin e çështjes në gjyq, subjekti i rivlerësimit, po ashtu, referon se nga hetimet është përgjuar dhe numri i telefonit celular ***, në përdorim të shtetasit ***.***, i cili ka kryer këto biseda me mesazh, me këtë përmbajtje, me shtetasin ***.***, me numrin ***, në kohën që forcat e policisë kanë qenë duke ushtruar kontroll në zonën *** dhe ***: [...] *Ej aman shko me *** atje se s'mun lëviz prz e madh me vdek se është me tension 22* [...].

17.2.13 Komisioni, gjatë hetimit administrativ, ka administruar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor, Krujë, vendimin nr.***/***, datë **.11.2021, marrë në përfundim të gjykimit. Edhe në vendimin e gjykatës, ndër transkriptimet e pasqyruara është dhe transkripti i bisedës me mesazh tekst (SMS) të dërguar nga numri në përdorim i ***.***, me përmbajtjen e reduktuar: [...] *Ej aman shko me *** atje se s'mun lëviz prz e madh me vdek se është me tension 22* [...]. Në përfundim të shqyrtimit gjyqësor¹⁰, që u krye në kushtet e gjykimit të shkurtuar, parashikuar nga neni 403 e vijues i KPRP, subjekti i rivlerësimit, ndër të tjera, ka kërkuar [...] (i) Deklarimin fajtor të pandehurit ***.***, për kryerjen e veprës penale të “Moskallëzimit të krimit”, të parashikuar nga neni 300 i K. Penal, dhe dënimin e tij me 2 vite burgim dhe mbi këtë masë dënimi të aplikohet neni 406 i K. Penal, duke u dënuar përfundimisht me 16 muaj burgim, si dhe shuarje të masës së sigurimit personal; (ii) Deklarimin fajtor të pandehurit ***.*** për kryerjen e veprës penale të “Moskallëzimit të krimit”, të parashikuar nga neni 300 i K. Penal, dhe dënimin e tij me 2 vite burgim, dhe mbi këtë masë dënimi të aplikohet neni 406 i K. Penal duke u dënuar përfundimisht me 16 muaj burgim, si dhe aplikim të nenit 59 të K. Penal për pjesën e mbetur të dënimit [...]. Rezultoi se disponimi përfundimtar i gjykatës ka pranuar kërkimet e subjektit të rivlerësimit, për cilësimin juridik, llojin dhe masën e dënimit, pezullimin e ekzekutimit të dënimit.

¹⁰ Pasqyruar në vendimin e Gjykatës së Rrethit Krujë nr.***/***, datë **.11.2021.

17.2.14 Sa më sipër Komisioni, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, i ka kaluar subjektit barrën e provës, pasi ka konstatuar se: [...] (i) Duket se transkripti i bisedës së SMS-së të dërguar nga numri *** që i përket ***, dërguar një numri tjetër, në kërkesën për gjykim të datës *.3.2021, të subjektit, nuk është i plotë, krahasuar me tekstin e po këtij transkripti të pasqyruar nëpër aktet e hetimit, kur shtetasit *** dhe ***, ishin në hetim për veprën penale të “kultivimit të bimëve narkotike”; (ii) Duket se subjekti i rivlerësimit nuk ka çmuar vlerën, rëndësinë e kësaj prove (transkripti i sms) dhe të përmbajtjes së tij në raport me provat e tjera, duke zbehur kështu vlefshmërinë procedurale të saj, me qëllim lehtësimin e pozitës së dy të pandehurve; (iii) Si rrjedhojë, për këta dy të pandehur, subjekti duket se e ka kualifikuar veprën penale në atë kategori për të cilën ligji parashikon një dënim më të lehtë sesa vepra penale në ngarkim të të pandehurve të tjerë, në kundërshtim me nenin 152 të K. Pr. Penale; (iv) Duket se subjekti i rivlerësimit në konkluzionet përfundimtare nuk ka argumentuar arsyen përse për të dy të pandehurit, të cilët ndodhen në kushte të njëjta akuzuar për të njëjtën veprë penale, ka mbajtur qëndrim ndryshe në individualizimin e dënimit (duke aplikuar vetëm për të pandehurin ***, nenin 59 të K. Penal) [...].

17.2.15 Subjekti i rivlerësimit në përgjigje të rezultateve të hetimit, ndër të tjera, ka shpjeguar se: [...] Lidhur me faktin e pretenduar nga Komisioni, se transkripti i bisedës së SMS-së ... nuk është i plotë, krahasuar me tekstin e po këtij transkripti, të pasqyruar nëpër aktet e hetimit,... theksojmë se, bazuar në nenin 332/ë, pika 2, germa “F”, të Kodit të Procedurës Penale, nga ana e prokurorit, në fashikullin e gjykimit dërguar gjykatës janë futur të plota të gjitha procesverbalet dhe regjistrimet e përgjimit të bisedimeve e komunikimeve, që janë kryer lidhur me këtë procedim penal, duke mos anashkaluar asnjërin prej tyre, fakt ky i pranuar në raport dhe nga vetë Komisioni... Vendimmarrja e prokurorit për këtë çështje është vlerësuar e drejtë dhe e saktë dhe nga gjykata, dhe kjo çështje është ende në gjykim, në pritje të shqyrtimit dhe të një vendimmarrje nga Gjykata e Apelit Tiranë, bazuar në ankimet e ushtruara nga të pandehurit. Duke qenë një çështje e cila është ende në gjykim, lidhur me raste të ngjashme Kolegji i Posaçëm të Apelit¹¹[...].

17.2.16 Në përfundim, Komisioni, ndër të tjera, ka vlerësuar: [...] Komisioni vëren se subjekti i rivlerësimit ka dhënë shpjegime të mjaftueshme në lidhje me këtë çështje. Kërkesa për gjykim e subjektit të rivlerësimit nuk është bazuar vetëm në një përgjigje të vetëm, por është hartuar në kompleksitet me provat e tjera që u përfituan edhe nga hetimet shitesë pas detyrave të lëna nga Gjykata e Shkallës së Parë... Komisioni, bazuar në hetimin administrativ dhe shpjegimet e subjektit, arriti në përfundimin se të dhënat e referuara në Raportin e DSIK-së nuk provojnë implikimin e subjektit të rivlerësimit në veprime të paligjshme me natyrë korruptive, ndikim të paligjshëm apo kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar (në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë). Komisioni vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka arritur një nivel të besueshëm për kriterin e figurës dhe sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të aneksit të Kushtetutës, duke konfirmuar përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës [...].

17.3 Komisioneri Publik ndan qëndrim të ndryshëm nga Komisioni, pasi ndonëse rastet e referuara në Raportin e DSIK-së, që ngrenë dyshime për veprime të paligjshme, në dukje nuk përmbajnë elemente që të cilësohen me ndikim në vlerësimin e kriterit për kontrollin figurës, sipas përcaktimeve të nenit DH të aneksit të Kushtetutës dhe në funksion të përcaktimit të

¹¹ Subjekti i referohet qëndrimit të Kolegjit, në vendimin (JR) nr. 33/2022, ku, ndër të tjera, ka arsyetuar: [...] Vlerësimi i Komisionit për faktet e denoncuar nga shtetasi ***, nuk qëndron, pasi çështja e analizuar vijonte të ishte në hetim dhe gjykim, në kohën e dhënies së vendimit për procesin e rivlerësimit ndaj subjektit të rivlerësimit, duke u analizuar në këtë mënyrë nga Komisioni, në kundërshtim me nenin E të aneksit të Kushtetutës [...].

ekzistencës së kontakteve të papërshtatshme, në dritën e nenit 38 të ligjit nr. 84/2016, elementet e këtij procedimi, në raport dhe me gjetjet e tjera, duhen vlerësuar dhe trajtuar si situata të cilat mund të ndikojnë në cenimin e besimit të publikut, në kuptim të nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016.

17.4 Në këto rrethana, Komisioneri Publik vlerëson se edhe pretendimi i subjektit se kjo çështje nuk mund të merret në analizë, duke qenë një çështje që është ende në gjykim në pritje të shqyrtimit dhe të një vendimmarrje nga Gjykata e Apelit Tiranë, duke e lidhur me raste të ngjashme të trajtuara nga Kolegji, nuk gjendet e bazuar, së pari, pasi kjo çështje është marrë në shqyrtim nga Komisioni në kuadër të vlerësimit të kriterit të figurës, referuar përmbajtjes së raportit të DSIK-së, ku rezulton se disponohen të dhëna, mbi të cilat ngrihen dyshime për përfshirje në veprime të paligjshme, e ndryshme kjo rrethanë, nga ajo e verifikimit të aftësive profesionale të subjektit. Në këtë kontekst, në konsideratë dhe të jurisprudencës së Kolegjit, është e pamundur që në kuadër të vlerësimit të figurës të zbatohen standardet e kontrollit të aftësive profesionale, apo para rastit kur duhet t'i referohemi aplikimit të nenit E, pika 2 e aneksit të Kushtetutës. Së dyti, për shkak të procedurave të shqyrtimit të legjitimitetit të ngritjes së akuzës dhe cilësimit juridik të faktit penal nga ana e gjyqtarit të seancës paraprake, veprimet konkrete të subjektit të rivlerësimit janë pjesë e akteve dhe i janë nënshtruar njëherë kontrollit gjyqësor nga të dyja shkallët e gjykatave. Në çdo rrethanë¹², në konsideratë të jurisprudencës së Kolegjit¹³, këto shkaqe duhet të merren në konsideratë dhe në referencë të vendimmarrjes përfundimtare eventuale të juridiksionit.

17.5 Sa më sipër, Komisioneri Publik, për sa është administruar në dosje të Komisionit, në analizë të veprimeve procedurale të kryera nga subjekti i rivlerësimit gjatë procedimit penal nr.***/2019, të evidentuar në këtë kriter vlerësimi, konstaton se: (i) transkriptimi i bisedës telefonike të shtetasit ***.***, i paraqitur ndryshe nga sa ka rezultuar në veprimet përkatëse hetimore, duket se ka mundësuar lehtësimin e pozitës procedurale të këtij shtetasi, pasi procedimi penal i një personi për të cilin për një periudhë gati 8 muajore ishte hetuar nga Prokuroria për veprën penale të “Kultivimit të bimëve narkotike”, të parashikuar nga neni 284/2 i K. Penal dhe për të cilin ishte kërkuar masa e sigurimit personal “Arrest me burg”, ndryshoi në “Moskallëzim krimi”. (ii) Qëndrimi vijues i subjektit të rivlerësimit për cilësimin e ndryshëm juridik të veprës penale në këtë drejtim, ruhet dhe në ankimin e paraqitur kundër vendimit nr.*** të datës **.5.2020, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Krujë, ku argumentohet nevoja që për këta shtetas të kryhen veprime të mëtejshme hetimore, ankim nga i cili hoqi dorë prokurori i Apelit, Tiranë, duke e cilësuar ankimin e subjektit të rivlerësimit të pabazuar; (iii) mungon argumentimi ligjor i subjektit në konkluzionet përfundimtare, mbi arsyetimin se përse për të dy të pandehurit, të cilët ndodhen në kushte të njëjta, akuzuar për të njëjtën veprë penale, ka mbajtur qëndrim ndryshe në individualizimin e dënimit.

17.6 Komisioneri Publik konstaton se nga të dhënat e administruara si rezultat i *informacioneve të organeve ligjzbatuese*, duket se rezultojnë disa rrethana, të cilat të analizuara së bashku me rezultatet e tjera të hetimit, përfshirë vlerësimin e aftësive profesionale, në vlerësim të përgjithshëm të të tria kriterëve, si dhe të para në raport me njëra-tjetrën, duhen çmuar nga Kolegji i Posaçëm i Apelimit, në kuptim të nenit 4, pika 2, të ligjit nr. 84/2016, sipas parashikimeve të nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016.

¹² Referohuni vendimit (JR) nr. 28/2020, prg.14.7.

¹³ Referohuni vendimit (JR) nr.27/2021, të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, prg.19.15.

III. C. Lidhur me gjetjet në vlerësimin e aftësive profesionale

18. Nga aktet në dosje të Komisionit, rezulton se ndaj subjektit të rivlerësimit janë depozituar 5 denoncime/ankesa nga publiku. Komisioni ka gjetur të meta, në dy prej tyre, por ka vlerësuar se këto mangësi procedurale të konstatuara nuk arrijnë deri në atë nivel sa ndaj subjektit të rivlerësimit të aplikohet masa disiplinore e shkarkimit nga detyra, bazuar në nenin 61/4 të ligjit nr. 84/2016, konkretisht:

18.1 *Procedimi penal nr. ***/2018, denoncim i shtetasit ***.*** nr.*** prot., datë **6.2019*

18.1.1 Shtetasi ***.***, i është drejtuar Komisionit, duke parashtruar se, në cilësinë e kallëzuesit, nga ana e subjektit të rivlerësimit nuk ka marrë asnjë lloj njoftimi për ecurinë e hetimit dhe asnjë lloj informacioni për procedimin penal ***/2018, për veprën penale “Ndërtim i paligjshëm”, parashikuar nga neni 199/a/1 i Kodit Penal.

18.1.2 Me shkresën nr.*** prot. datë **.11.2021, të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Krujë, Komisioni ka administruar fashikullin penal nr.***/2018 me kallëzues z.***.***, nga ku i ka rezultuar se: (i) Kërkesa për pushimin e çështjes penale ***/2018, drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Krujë, datë **.10.2021, i është njoftuar vetëm personit nën hetim ***.***¹⁴ dhe jo kallëzuesit ***.***, në kundërshtim me nenin 329/a/4 të K. Pr. Penale; (ii) Subjekti i rivlerësimit ka zgjatur hetimet çdo 3 muaj për një periudhë gati 2-vjeçare (**.11.2019 – **.11.2021), për marrje dokumentacioni shtesë nga Bashkia Krujë. Ndërkohë kërkesa i është dërguar Bashkisë Krujë në datën **.3.2021, pas 15 muajsh, në kundërshtim me nenin 324/2 të K. Pr. Penal; (iii) Nuk rezulton që vendimet për zgjatjen afatit të hetimeve t’iu jenë njoftuar palëve të interesuara, sipas përcaktimeve të nenit 324/3 i K. Pr. Penale.

18.1.3 Komisioni, bazuar në nenin 52 të ligjit nr.84/2016, i ka kërkuar subjektit të rivlerësimit të japë shpjegime lidhur me faktet e konstatuara më sipër.

18.1.4 Subjekti i rivlerësimit, në përgjigje të rezultateve të hetimit të Komisionit, ndër të tjera, ka parashtruar se: [...] *Pavarësisht parashikimit ligjor, mosnjoftimi i kallëzuesit nga ana e prokurorit në përfundim të hetimeve, kur procedohet me pushimin e akuzës, nuk cenon të drejta procedurale të kallëzuesit ***.***, teksa pas komunikimit kallëzuesi nuk mund të kërkojë kryerjen e veprimeve të tjera nga prokurori, por qëndrimin e tij në lidhje me çështjen e paraqet përpara gjykatës që shqyrton kërkesën për pushim....**Në lidhje me konstatimin e zgjatjes së hetimeve çdo 3 muaj për një periudhë gati 2-vjeçare, sqaroj se këto zgjatje janë bërë në zbatim të neneve 324/2 e 325 të Kodit të Procedurës Penale, duke u marrë nga Prokurori vendimet “Për zgjatjen e afatit të hetimeve paraprake”, duke filluar nga data **.11.2019 dhe deri në datën **.8.2021, duke iu referuar faktit se nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë ishte vendosur në datën **.7.2019 kthimi i procedimit, me kërkesë të vetë prokurorit, siç u referua më lart.... Komisioni, gjatë vlerësimit të punës, duhet të ketë parasysh që gjatë kësaj periudhe, për shkak të procesit Vetting, volumi i punës i prokurorëve dhe i gjyqtarëve është rritur ndjeshëm, jashtë çdo mundësie objektive për kryerjen në një kohë më të shkurtër të veprimeve hetimore. Për sa i përket konstatimit të mos njoftimit të vendimeve për zgjatjen e afatit të hetimeve palëve të interesuara, sipas përcaktimeve të nenit 324/3 të Kodit të Procedurës Penale, sqaroj se në të gjitha vendimet e marra në këtë drejtim, për zgjatjen e afateve hetimore,***

¹⁴ Fakt ky i pasqyruar në kërkesën për pushim nga subjekti i rivlerësimit.

*unë si prokuror kam urdhëruar njoftimin e vendimit tek të interesuarit dhe në rastin konkret rezulton se të gjitha vendimet i janë njoftuar shtetasit ***.***, si person ndaj të cilit zhvillohen hetimet. Shtetasi ***.***, nuk është person i dëmtuar nga vepra penale, nga kryerja e veprës penale të pretenduar të “Ndërtimit të paligjshëm”, nuk i ka ardhur asnjë pasojë apo dëmtim të interesave të tij, si kallëzues..... duke mos pasur statusin e të dëmtuarit, mosnjoftimi i vendimeve, për zgjatjen e afatit të hetimeve te shtetasi ***.***, nuk cenon asnjë të drejtë procedurale të tij dhe as vetë cilësinë e hetimit [...].*

18.1.5 Komisioni, pas administrimit të shpjegimeve, të paraqitura nga subjekti me shkrim, pas rezultateve të hetimit dhe verbalisht në seancën dëgjimore, ka arsyetuar se: [...] *neni 329/a/4 të Kodit të Procedurës Penale e ka të përcaktuar qartë që kërkesa për pushimin e akuzës ose çështjes i njoftohet edhe personit që ka bërë kallëzim ose ankim. Për sa kohë është e përcaktuar proceduralisht, subjekti ka pasur detyrë ta njoftonte kallëzuesin dhe nuk ka lidhje me pasojën e mosnjoftimit të këtij vendimi. Njoftimi është një kërkesë procedurale, e cila duhet të përmbushet nga prokurori i çështjes.Për zgjatjen e afatit të hetimeve për një periudhë 2-vjeçare, kur vetëm pas 15 muajsh subjekti ndërmerr një veprim hetimor (dërgim shkresë te Bashkia Krujë) ngarkesa në punë e pretenduar nga subjekti nuk përbën shkak që ta shtyjë pambarimisht hetimin të kushtëzuar vetëm në dërgimin e një shkresë për marrje informacioni. ...Për mosnjoftimin e shtetasit ***.***, me arsyen se nuk ka statusin e të dëmtuarit në kallëzim, Komisioni vëren se ky arsyetim nuk qëndron, për sa kohë që edhe shtetasi ***.***, i cili është njoftuar nga subjekti, nuk ka statusin e të pandehurit (siç përcakton Kodi i Procedurës Penale), por statusin e personit nën hetim ¹⁵[...].*

18.1.6 Në përfundim, Komisioni ka vlerësuar se këto mangësi procedurale të konstatuara nuk arrijnë deri në atë nivel, sa ndaj subjektit të rivlerësimit të aplikohet masa disiplinore e shkarkimit nga detyra, bazuar në nenin 61/4 të ligjit nr. 84/2016.

18.1.7 Komisioneri Publik ndan qëndrim të ndryshëm mbi mangësitë procedurale të konstatuara, pasi duket se pretendimet e denoncuesit gjejnë mbështetje në aktet në dosje.

18.1.8 Nga aktet e administruara, duket se nuk është zbatuar kërkesa procedurale mbi njoftimin e kallëzuesit të kërkesës për pushimin e çështjes penale, si dhe nuk i janë njoftuar kallëzuesit disa kërkesa procedurale të bëra nga subjekti, për zgjatjen e afateve hetimore. Komisioneri Publik vlerëson se qëndrimi i shprehur nga subjekti i rivlerësimit se mosnjoftimi i shtetasit ***.***, me arsyen se nuk ka statusin e të dëmtuarit në kallëzim, nuk mund të justifikojë moszbatimin e një detyrimi ligjor të parashikuar nga neni 329/a/4 i Kodit të Procedurës Penale.¹⁶

18.1.9 Referuar këtyre të dhënave, Komisioneri Publik konstaton se subjekti i rivlerësimit ka treguar mangësi profesionale në trajtimin e kësaj çështjeje, në kuadër të aspektit të njohurive ligjore, pasi vlerëson se moskryerja e të gjitha veprimeve hetimore të nevojshme dhe zgjatja e përsëritur e afateve të hetimit, bien ndesh me kriteret e parashikuara në nenin 73, pikat 2 dhe 3, dhe nenin 74, pika 4 e ligjit nr. 96/2016, dhe duhen të merren në konsideratë nga Kolegji në vlerësimin tërësor të çështjes së subjektit të rivlerësimit, sipas nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016.

¹⁵ Referohuni vendimit të Komisionit, f. 43.

¹⁶ Referohuni vendimit të Kolegjit (JR) nr.19/2021, prg. 31.2.

18.2 *Procedimi penal nr. ***/2018*

18.3 Shtetasi ***.*** i është drejtuar Komisionit, duke parashtruar se subjekti i rivlerësimit nuk ka kryer asnjë veprim hetimor për rreth 18 muaj, nga data e regjistrimit të kallëzimit (**.12.2018) për procedimin penal nr. ***/2018, për veprën penale “Shkatërrim të pronës”, të parashikuar nga neni 150 i Kodit Penal.

18.3.1 Komisioni ka administruar nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Krujë¹⁷ fashikullin penal nr. ***/2018 me kallëzues ***.***, nga ku ka rezultuar se kërkesa për pushimin e çështjes penale nuk u është njoftuar palëve të interesuara në përputhje me nenin 329/a/4, fakt për të cilin subjektin iu kalua barra e provës për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.

18.3.2 Subjekti i rivlerësimit, në përgjigje të rezultateve të hetimit të Komisionit, ndër të tjera, ka parashtruar se: [...] *procedimi penal nr. *** është regjistruar më datën **.10.2018 dhe është paraqitur kërkesa për pushimin e çështjes penale në gjykatë më datë **.10.2021. Në rastin konkret, në lidhje me konstatimin tuaj se nuk është njoftuar z. ***.*** për kërkesën për pushimin e çështjes, ashtu siç kam analizuar edhe më parë, në referim të nenit 329/a, paragrafi i 4 i Kodit të Procedurës Penale, theksoj faktin se, pavarësisht parashikimit ligjor, mosnjoftimi i kallëzuesit nga ana e prokurorit në përfundim të hetimeve, kur procedohet me pushimin e akuzës, nuk cenon të drejta procedurale të kallëzuesit, teksa pas komunikimit kallëzuesi nuk mund të kërkojë kryerjen e veprimeve të tjera nga prokurori, por qëndrimin e tij në lidhje me çështjen e paraqet përpara gjykatës që shqyrton kërkesën për pushim...Në zgjatjen e afateve të veprimeve hetimore ka ndikuar edhe shpallja e gjendjes së jashtëzakonshme, pandemia Covid-19, faktor i cili ka paralizuar për një periudhë të gjatë punën në institucionet e vendit tonë, gjë e cila automatikisht ka reflektuar edhe në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë, Krujë...Komisioni gjatë vlerësimit të punës duhet të ketë parasysh që gjatë kësaj periudhe, për shkak të procesit të Vetting-ut, volumi i punës i prokurorëve dhe i gjyqtarëve është rritur ndjeshëm, jashtë çdo mundësie objektive për kryerjen në një kohë më të shkurtër të veprimeve hetimore. Personalisht theksoj fatin se kam qenë i angazhuar edhe në detyra të tjera funksionale brenda Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor, Krujë [...].*

18.3.3 Komisioni, pas administrimit të shpjegimeve me shkrim, të paraqitura nga subjekti, në përgjigje të rezultateve të hetimit, ka arsyetuar se subjekti i rivlerësimit nuk ka përmbushur kërkesat procedurale (*mosnjoftimi i kërkesës për pushim palëve*), për shkak të ngarkesës në punë. Përfundimisht, lidhur me këtë denoncim ka vlerësuar se këto mangësi procedurale të konstatuara nuk arrijnë deri në atë masë sa ndaj subjektit të rivlerësimit të aplikohet masa disiplinore e shkarkimit nga detyra, bazuar në nenin 61/4 të ligjit nr. 84/2016¹⁸.

18.3.4 Komisioneri Publik vlerëson se subjekti nuk ka dhënë shpjegime bindëse mbi gjetjet dhe të metat e veprimeve procedurale të kryera prej tij e të konstatuara në aktet e fashikullit procedural për këtë denoncim dhe duket se pretendimet e denoncuesit mbështeten në aktet në dosje.

18.3.5 Komisioneri Publik, në analizë të përmbajtjes së denoncimit, akteve të administruara në fashikullin penal dhe parashtrimeve të subjektit të rivlerësimit, konstaton se subjekti i rivlerësimit, në drejtim të zgjidhjes së çështjes, ka ndërmarrë si veprim të fundit hetimor

¹⁷ Shkresa e Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor, Krujë, me nr. *** prot., datë **.11.2021.

¹⁸ Referohuni vendimit të Komisionit, f. 44.

kryerjen e aktit të ri të ekspertimit në maj të vitit 2020 dhe ka proceduar me kërkesën për pushimin e kësaj çështje penale në datë **.10.2021.

18.3.6 Nga aktet e administruara, duket se nuk është zbatuar kërkesa procedurale mbi njoftimin e kallëzuesit të kërkesës për pushimin e çështjes penale. Komisioneri Publik, edhe në këtë rast, vlerëson se qëndrimi i shprehur nga subjekti i rivlerësimit për mosnjoftimin e shtetasit ***.***, me argumentin se kërkesa i është komunikuar kallëzuesit nga vetë gjykata, nuk mund të justifikojë moszbatimin e një detyrimi ligjor të parashikuar nga neni 329/a/4 i Kodit të Procedurës Penale.

18.3.7 Referuar akteve të administruara, Komisioneri Publik konstaton se subjekti i rivlerësimit ka treguar mangësi profesionale në trajtimin e kësaj çështjeje, në kuadër të aspektit të njohurive ligjore, pasi vlerësohet se moskryerja e të gjitha veprimeve hetimore të nevojshme dhe tejzgjatja e afateve të hetimit, dhe jo në përputhje me dispozitat ligjore, në raport me veprimet e kryera për të mbledhur provat e nevojshme, bien ndesh me kriteret e parashikuara në nenin 73, pikat 2 dhe 3, dhe nenit 74, pika 4 e ligjit nr. 96/2016, dhe duhen të merren nga Kolegji në konsideratë në vlerësimin tërësor të çështjes së subjektit të rivlerësimit, sipas nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016.

19. Në përfundim të shkaqeve të ankimit të trajtuar më sipër, në zbatim dhe të jurisprudencës së Kolegjit, për kriterin e vlerësimit të pasurisë, të figurës dhe të aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit, vlerësojmë se deklarimet e pasakta të subjektit të rivlerësimit, veprimet juridike kryer vetëm për dukje lidhur me transaksionet e blerjeve, duke u përpjekur të paraqesë në mënyrë të pasaktë pasuritë në posedim dhe pronësi të tij, si dhe të metat e konstatuara në shqyrtimin e çështjeve të trajtuara gjatë kontrollit të figurës dhe aftësive profesionale, duhet të merren në konsideratë në vlerësimin tërësor të të tria kriterëve për subjektin e rivlerësimit, në kuadër të cenimit të besimit të publikut tek sistemi i drejtësisë, sipas nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016.

IV. Kërkimi i ankimit

20. Nisur nga parashikimi i nenit 179/b, pika 5, të Kushtetutës dhe aneksit të Kushtetutës, ndryshe nga sa disponon shumica e trupës gjykuese, për kriteret e rivlerësimit, referuar gjendjes së fakteve dhe provave në rastin konkret, Komisioneri Publik ndan qëndrim të kundërt, pasi vlerëson se subjekti i rivlerësimit nuk arrin nivel të besueshëm për konfirmimin e tij në detyrë;

21. Duke ritheksuar se Komisioneri Publik ka detyrimin që të ushtrojë kontroll mbi vendimet e dhëna nga Komisioni, me qëllim që të garantojë mbrojtjen e interesit publik në procesin e rivlerësimit, duke vlerësuar në qoftë se vendimmarrja e Komisionit për konfirmimin ose shkarkimin e subjektit, ose ndërprerjen e procesit të rivlerësimit është marrë në përputhje me ligjin, në përfundim të një hetimi të plotë, mbështetur në faktet dhe provat e administruara për këtë qëllim;

22. Nisur nga fakti se Komisioneri Publik është i detyruar që kompetencën e tij për të ushtruar ankim ndaj vendimeve të Komisionit, ta mbështesë vetëm në aktet dhe provat e administruara gjatë kryerjes së procesit të rivlerësimit nga ana e Komisionit;

23. Bazuar në nenin Ç, E dhe F, të aneksit të Kushtetutës, Kreun VI dhe nenin 61, pika 5, të ligjit nr. 84/2016;

24. Komisioneri Publik kërkon që shkaqet e këtij ankimi të merren në shqyrtim nga ana e Kolegjit të Posaçëm të Apelit dhe, në zbatim të nenit 66, pika 1, germa “b”, të ligjit nr. 84/2016, në përfundim të shqyrtimit të çështjes në seancë publike, të vendosë:

- Ndryshimin e vendimit nr. 537, datë 2.6.2022, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, dhe shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, z. Florian Bonjaku.

KOMISIONERI PUBLIK

Florian BALLHYSA